

Mjekëve u ndalohet takimi me kompanitë farmaceutike në QKMF

Arian Duriqi

LIPJAN, 18 QERSHOR – Komuna e Lipjanit ditë më parë ka nxjerrë një aktvendim sipas të cilit u ndalohet të gjithë mjekëve të QKMF-së takimi në ordinancë të këtij institucioni mjekësor me përfaqësues të kompanive farmaceutike, të cilët kanë për qëllim reklamimin e barnave të tyre. Vendimi mban datën 30 të muajit të kaluar, ndërsa vjen si rezultat i disa raportimeve të fundit në KD për dyshime serioze se disa mjekë që punojnë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan janë të lidhur fshehtas me disa kompani farmaceutike me qëllim të promovimit dhe të shitjes së produkteve të tyre. Për më tepër, mjekët, ndërkaq, të cilët nuk e respektojnë vendimin që ka nxjerrë Komuna, përkatësisht Drejtorja e Shëndetësisë, paralajmërohen se do të përballen me pasojë të ashpra ligjore.

“Të gjithë mjekëve në QKMF të Lipjanit u ndalohet takimi në ordinancë me përfaqësues të kompanive farmaceutike, e të cilët kanë për qëllim reklamimin e produkteve të tyre. Ndërkohë që, të gjithë mjekët janë të obliguar po ashtu që shënimin e barnave në receta ta bëjnë me emra gjenerikë, derisa mosrespektimi i këtij vendimi do të ketë pasojë ligjore ndaj përgjegjësve”, thuhet në vendimin që është nënshkruar nga Avdullah Fazliu, drejtor i Shëndetësisë në Lipjan.

Në arsyetim të vendimit, ndërkaq, saktësohet ajo që ishte paralajmëruar se takimet e mjekëve me kompani farmaceutike janë në kundërshtim me ligjet në fuqi. “Vizita e përfaqësuesve të kompanive farmaceutike nëpër ordinancë mjekësore të QKMF-së dhe



“Të gjithë mjekëve në QKMF të Lipjanit u ndalohet takimi në ordinancë me përfaqësues të kompanive farmaceutike, të cilët kanë për qëllim reklamimin e produkteve të tyre. Ndërkohë që të gjithë mjekët janë të obliguar po ashtu që shënimin e barnave në receta ta bëjnë me emra gjenerikë, derisa mosrespektimi i këtij vendimi do të ketë pasojë ligjore ndaj përgjegjësve”, thuhet në vendimin që është nënshkruar nga Avdullah Fazliu, drejtor i Shëndetësisë në Lipjan

takimi i tyre me mjekët e këtij institucioni me qëllim të reklamimit të barnave mund të pengojë punën e mjekëve. Ndërsa ky veprim është në kundërshtim me Ligjin mbi shëndetësinë të Republikës së Kosovës 04/L-125, neni 42 paragrafi 2”, thuhet në arsyetim të vendimit. Ndërkohë që këtë vendim e ka përshëndetur edhe shoqëria civile në Lipjan. Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në OJQ-në YAHR, ka thënë se, megjithatë, pas shumë reagimeve publike ka ardhur edhe vendimi që do të duhej të merrej qysh pas reagimit të parë. Krasniqi ka shtuar se meqë në Lipjan është vërejtur se në institucione shëndeti po reklamohen produkte kompanish farmaceutike, autoritetet komunale kanë bërë mirë që e kanë

nxjerrë vendimin për ta parandaluar këtë gjë. “Organizata joqeveritare YAHR ka shprehur disa herë shqetësimin edhe publik lidhur me këtë dukuri shumë shqetësuese që ndodhte në sektorin e shëndetësisë në Komunën e Lipjanit. Sepse, ka individë të caktuar që punojnë në sektorin privat dhe atë publik të shëndetësisë e që në mënyrë direkte janë lidhur me kompani të caktuara farmaceutike me qëllim të promovimit dhe të shitjes të produkteve të tyre në dëm të qytetarëve. Prandaj, me vendimin që parandalon këtë dukuri ndihmohen vetë qytetarët”, ka thënë Krasniqi.

© KOHA Ditore